



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS GLLOGOC

Numri i lëndës: 2020:093889

Datë: 31.01.2024

Numri i dokumentit: 05264770

C. nr. 973/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC, Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Astrit Gashi, në çështjen juridike të paditëses **E.C** nga Gllogoci, të cilën e përfaqëson i autorizuari i saj H.K, nga Gllogoci, kundër të paditurës Komuna e Gllogocit, Drejtoria për Arsim, me objekt kontesti kompensim i shujtës ditore dhe udhëtimit, vlera e kontestit 990.00 €, jashtë seancës gjyqësore me datën 26.01.2024 e mori këtë:

A K T V E N D I M

- I. KONSTATOHET SE ËSHTË TËRHEQUR** padia e paditëses **E.C** nga Gllogoci, paraqitur kundër të paditurës Komuna e Gllogocit, Drejtoria për Arsim me datën 07.08.2020, lidhur me kompensimin e shujtave ditore dhe udhëtimit, vlera e kontestit 990.00 €.
- II. OBLIGOHET** paditësja **E.C** që në afatin prej 7 ditë të bëjë pagesën e taksës gjyqësore për padi në shumën prej 20 Euro në llogarinë bankare të KGJK-së, nën kërcënim të përmbarrimit me dhunë.

A r s y e t i m

Paditësja **E.C** nga Gllogoci përmes të autorizuarit të saj në këtë gjykatë ka parashtruar padi me datën 07.08.2020 kundër të paditurës Komuna e Gllogocit, Drejtoria për Arsim në Gllogoc, lidhur me kompensimin e shujtës dhe udhëtimit, vlera e kontestit 990.00 €.

I autorizuari i paditëses me parashtrësën e datës 25.01.2024 e ka tërhequr padinë C.nr. 973/2020 të datës 07.08.2020 kundër të paditurës lidhur me shpenzimet e shujtës ditore dhe udhëtimit duke theksuar se paditësja kërkesën për kompensimin e shujtave ditore dhe udhëtimit e ka realizuar në procedurën administrative duke bashkangjitur edhe fletëpagesën bankare të datës 16.07.2022.

Neni 261 par. 4 i LPK-së përcakton se “*Kundër aktvendimit me të cilin konstatohet se është tërhequr padia nuk lejohet ankimi*”. Ndërsa të drejtën e ankesës kundër pikës II të dispozitivit të këtij aktvendimi e përcakton Neni 477 i LPK-së.

Gjykata duke u bazuar në Nenin 387. par. 1 pika c, lidhur me Nenin 261 par.1,3,4 dhe 5 të LPK-së, ka marrë aktvendim me të cilin ka konstatuar se paditësja e ka tërhequr padinë ndaj të paditurës në këtë çështje juridike lidhur me kërkesën kryesore dhe ka vendosë si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi. Ndërsa për pikën II të këtij aktvendimi, gjykata ka vendosur në

pajtim me Nenin 473 par. 1 dhe par. 3 të LPK-së lidhur me tarifën nr. 12-pika 1 të Udhëzimit Administrativ të KGJK-së Nr. 01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

Nga sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEGA NË GLLOGOC,
Departamenti i përgjithshëm, Divizioni civil, C. nr. 973/2020, me datë 26.01.2024**

**Gjyqtari
Astrit Gashi**

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër pikës I të këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, ndërsa kundër pikës II të aktvendimit lejohet ankesa në afat prej 7 ditë pas pranimit të të njëjtit për Gjykatën e Apelit e nëpërmjet kësaj gjykate.